

VENDIM
Nr. 549, datë 18.6.2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1705, DATË 29.12.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR REGJISTRIMIN E TREGUESVE GJEORAFIKË””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 177, 180, 181, 182 e 202, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1705, datë 29.12.2008, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 1 shtohen pikat 1.1 dhe 1.2, si më poshtë vijon:

“1.1 Në të gjithë formularët e treguesve gjeografikë, para rubrikës “Nënshkrimi i apli-kantit ose përfaqësuesit të tij” shtohet rubrika me këtë përmbajtje:

“Meqenëse DPPM-ja është në posedim të të dhënave të mia, të cilat, sipas ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, përkufizohen si “të dhëna personale”, të cilat i kam dhënë personalisht, me qëllim përfitimin e shërbimeve të ofruara, jap miratimin për përpunimin e të dhënave në funksion të shërbimeve të kërkuara nga unë ose të kërkueshme nga DPPM-ja, për përpunimin e të dhënave nëpërmjet letrash, telefonit, SMS-ve, internetit ose formave të tjera të komunikimit.

DPPM-ja merr përsipër përgjegjësinë se informacioni do të mbrohet dhe trajtohet sipas legjislacionit në fuqi.”.

1.2 Bashkëlidhur këtij vendimi shtohet formulari FTG7 për ripërtëritjen e treguesit gjeografik dhe në të gjithë formularët e treguesve gjeografikë të higen logoja dhe adresa e Zyrës e të vendosen sipas vendit ku DPPM-ja do të ushtrrojë aktivitetin e saj.”.

2. Në rregulloren për regjistrimin e treguesve gjeografikë, miratuar me vendimin nr. 1705, datë 29.12.2008, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

2.1 Shkronjat “ç”, “d” dhe “ë”, të pikës 2.1, të kreut II, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“ç) një dokument të lëshuar nga autoriteti kompetent, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, i cili përcakton kufijtë e zonës gjeografike ku prodhohet ose përpunohet produkti. Autoriteti përkatës për produktet bujqësore dhe ushqimore, në kuptim të pikës 2, të këtij neni, është ministria përgjegjëse për bujqësinë;

d) një dokument të lëshuar nga autoriteti kompetent, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, i cili përcakton vetitë dhe karakteristikat e produktit, si dhe lidhjen ndërmjet vetive dhe karakteristikave të produktit me mjedisin gjeografik ose origjinën gjeografike, në përputhje me parashikimin e pikës 2, të nenit 177, të ligjit. Autoriteti përkatës për produktet bujqësore dhe ushqimore, në kuptim të pikës 2, të këtij neni, është ministria përgjegjëse për bujqësinë.

ë) kur produkti është ushqimor ose bujqësor, një dokument të lëshuar nga ministria përgjegjëse për bujqësinë, i cili vërteton se produkti i përmbush të gjitha kriteret për cilësinë, të parashikuara nga legjislacioni përkatës në fuqi.”.

2.2 Kreu III riformulohet, si më poshtë vijon:

“Kreu III

Ekzaminimi formal i kërkesës për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe ekzaminimi i aplikimit në lidhje me bazat absolute për refuzim

1. Rendi dhe afatet e ekzaminimit të aplikimit

1.1 Kërkesat për regjistrimin e treguesve gjeografikë ekzaminohen nga DPPM-ja, sipas radhës së paraqitjes së tyre.

1.2 Një kërkesë ekzaminohet jashtë radhës nëse ekziston një konflikt rreth shkeljes së të drejtave të treguesit gjeografik. Ekzaminimi jashtë radhës bëhet nga ekzaminuesi pasi aplikanti të paraqesë një kërkesë me shkrim dhe të paguajë tarifën përkatëse.

1.3 Ekzaminimi i aplikimit për regjistrimin e treguesit gjeografik bëhet brenda periudhës tremujore nga data e paraqitjes së tij. Brenda kësaj periudhe ekzaminuesi shqyrton nëse aplikimi plotëson kushtet e nenit 182, të ligjit në fuqi, dhe të pikës 2, të kreut II, të kësaj rregulloreje.

2. Ekzaminimi i aplikimit dhe njohja e datës së depozitimit

2.1 Nëse aplikimi i përmbush të gjitha kërkesat e nenit 182, të ligjit në fuqi, dhe të pikës 2, të kreut

II, të kësaj rregulloreje, DPPM-ja bën depozitimin e aplikimit për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe i lëshon aplikantit dëshminë e depozitimit, duke njohur si datë depozitimi datën e paraqitjes së aplikimit.

2.2 Nëse aplikimi nuk i përmbush të gjitha kërkesat e nenit 182, të ligjit, dhe të pikës 2, të kreut II, të kësaj rregulloreje, DPPM-ja njofton aplikantin për të bërë plotësimet brenda tre muajve nga data e njoftimit. Periudha për paraqitjen e plotësimeve mund të zgjatet deri në një muaj shtesë, nëse aplikanti paraqet një kërkesë me shkrim dhe paguan tarifën përkatëse. Në çdo rast, kërkesa për zgjatjen e afatit duhet të depozitohet pranë DPPM-së, pa mbaruar afati tremujor i caktuar për plotësimin e të metave të aplikimit.

2.3 Nëse aplikanti nuk i kryen plotësimet brenda afatit të caktuar, DPPM-ja e refuzon kërkesën për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe i lëshon aplikantit njoftimin e refuzimit të aplikimit.

2.4 Kur aplikanti i kryen plotësimet e kërkuara brenda kohës së caktuar, DPPM-ja depoziton aplikimin dhe i lëshon aplikantit dëshminë e depozitimit, brenda tre muajve nga data kur aplikanti ka plotësuar të metat e kërkesës, duke njohur si datë depozitimi të aplikimit datën e paraqitjes së tij.

2.5 Kur të metat e aplikimit kanë të bëjnë me emrin dhe adresën e aplikantit, treguesin gjeografik, produktin për të cilin regjistrohet treguesi ose me mospagesën e tarifës së depozitimit, datë depozitimi e aplikimit do të njihet data e plotësimit të të metave. Në rastin kur të metat lidhur me ndonjë prej elementeve të lartpërmendura kanë të bëjnë me gabime të tilla që nuk cenojnë thelbin e këtyre elementeve, si datë depozitimi e kërkesës do të njihet data në të cilën aplikimi është paraqitur pranë DPPM-së.

3. Dëshmia e depozitimit

3.1 Dëshmia e depozitimit përmban të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin e treguesit gjeografik;
- b) emrin dhe adresën e aplikantit;
- c) datën e depozitimit dhe numrin e kërkesës;
- ç) produktin për të cilin mbrohet treguesi gjeografik.

4. Ekzaminimi në lidhje me shkaqet absolute për refuzim

4.1. DPPM-ja, brenda tre muajve nga data e depozitimit të aplikimit për regjistrimin e një treguesi gjeografik, ekzaminon nëse treguesi, përveç përmbushjes së kërkesave formale, është në përputhje edhe me kërkesat e shkronjave “a” dhe “b”, të nenit 180, të ligjit në fuqi.

4.2. Gjatë ekzaminimit, DPPM-ja mund t’i kërkojë aplikantit materiale dhe dokumente shtesë, nëpërmjet një njoftimi me shkrim. Aplikanti duhet t’ia paraqesë DPPM-së doku-mentet e kërkuara brenda dy muajve nga data e njoftimit, në të kundërt kërkesa refuzohet dhe paraqitësi i saj njoftohet për refuzimin nëpërmjet një njoftimi me shkrim, ku paraqiten dhe arsyet e refuzimit të kërkesës.

4.3 Kur nga ekzaminimi i aplikimit rezulton se ai bie në kundërshtim me kërkesat e shkronjave “a” dhe “b”, të nenit 180, të ligjit në fuqi, edhe pas përgjigjes së aplikuesit, DPPM-ja e refuzon atë dhe njofton aplikantin, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, ku paraqiten arsyet e refuzimit të kërkesës.”

Kreu IV riformulohet, si më poshtë vijon:

“Kreu IV

Regjistrimi i treguesit gjeografik

1. Regjistrimi i treguesit gjeografik

1.1. DPPM-ja njofton aplikuesin të paguajë tarifën e regjistrimit pas kalimit të afatit tremujor nga data e publikimit të treguesit, nëse nuk janë depozituar kundërshtime apo kundërshtimet janë refuzuar dhe i kërkon aplikantit që, brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit, të bëjë pagesën e tarifës dhe një kopje të dokumentit të pagesës ta depozitojë pranë DPPM-së.

1.2. Nëse aplikanti nuk e paguan tarifën e regjistrimit brenda afatit të caktuar, DPPM-ja refuzon aplikimin dhe njofton me shkrim aplikantin.

1.3. Kur aplikanti e paguan tarifën e regjistrimit brenda afatit të caktuar, DPPM-ja e regjistron treguesin gjeografik në regjistrin përkatës dhe lëshon certifikatën e regjistrimit brenda një periudhe tremujore nga data e pagesës së tarifës.

DPPM-ja publikon treguesin gjeografik të regjistruar në Buletinin e Pronësisë Industriale.

2. Të dhënat që përmban certifikata e regjis-trimit të treguesit gjeografik

2.1. Certifikata e regjistrimit të treguesit gjeo-grafik duhet të përmbajë:

- a) emërtimin e treguesit gjeografik;
- b) emrin dhe adresën e pronarit të treguesit gjeografik;
- c) numrin e kërkesës dhe numrin e regjistrimit të tij;
- ç) datën e depozitimit dhe datën e regjistrimit;

d) produktin për të cilin është regjistruar treguesi gjeografik.

3. Kryerja e ndryshimeve ose heqja dorë nga aplikimi

3.1. Kur aplikimi për regjistrimin e një treguesi gjeografik është në proces ekzaminimi dhe ka ndodhur ndryshimi i emrit dhe/ose adresës së aplikantit, DPPM-ja, kundrejt depozitimit nga aplikanti të formularit përkatës, dokumenteve që provojnë ndryshimin e mësipërm dhe pagesës së tarifës përkatëse, e regjistron treguesin me të dhënat e reja në regjistrin e treguesve gjeografikë, pa ndryshuar datën e depozitimit të aplikimit.

3.2. Aplikanti ka të drejtë të heqë dorë nga aplikimi për regjistrimin e treguesit gjeografik, nëpërmjet një kërkesë me shkrim, për aq kohë sa ai nuk është regjistruar ende në regjistrin e treguesve gjeografikë. Me depozitimin e një kërkesë të tillë, aplikimi konsiderohet i tërhequr.”.

2.4 Pas kreut X shtohet kreu XI, me këtë përmbajtje:

“Kreu XI

Ripërtëritja e treguesit gjeografik

1. Paraqitja e kërkesës për ripërtëritjen e treguesit gjeografik

Në zbatim të nenit 181, pika 3, të ligjit në fuqi, aplikimi për ripërtëritjen e treguesit gjeo-grafik duhet të përmbajë:

a) formularin FTG7, të nënshkruar nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij, i cili duhet të përmbajë në mënyrë të veçantë të dhënat për emrin dhe adresën e aplikantit, treguesin gjeografik, përcaktimin e produktit për të cilin do të përdoret treguesi gjeografik, si dhe përcaktimin e kufijve të lokalitetit gjeografik ku prodhohet ose përpunohet produkti;

b) dokumentin e pagesës së tarifës së depo-zitimit;

c) një dokument të lëshuar nga autoriteti kompetent, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, i cili përcakton vetitë dhe karakteristikat e produktit, si dhe lidhjen ndërmjet vetive dhe karakteristikave të produktit me mjedisin gjeografik ose origjinën gjeografike, në përputhje me parashikimin e pikës 2, të nenit 177, të ligjit në fuqi. Autoriteti përkatës për produktet bujqësore dhe ushqimore, në kuptim të pikës 2, të këtij neni, është ministria përgjegjëse për bujqësinë.

ç) kur aplikanti është një person fizik ose juridik i huaj, dokumentin që vërteton regjistrimin e treguesit gjeografik në vendin e origjinës, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar;

d) autorizimin e përfaqësimit, nëse aplikimi paraqitet nga përfaqësuesi i aplikantit. Autorizimi i përfaqësimit duhet të përmbajë nënshkrimin e aplikantit, dhe, kur aplikanti është person juridik, edhe vulën e tij.

2. Shqyrtimi i kërkesës nga DPPM-ja

2.1 DPPM-ja shqyrton kërkesën për ripërtëritjen e treguesit gjeografik nëse është në përputhje me parashikimet e pikës 1, të këtij kreu, dhe në rast se ka të meta, njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 3 muajve nga data e njoftimit, në të kundërt kërkesa refuzohet.

2.2 Kur kërkesa për ripërtëritjen e treguesit gjeografik është në përputhje me parashikimet e pikës 1, të këtij kreu, DPPM-ja e regjistron ripërtëritjen në regjistrin e treguesve gjeografikë dhe lëshon certifikatën e ripërtëritjes, brenda 6 muajve nga data kur aplikimi plotëson të gjitha kërkesat e pikës 1, të këtij kreu.

2.3 Certifikata e ripërtëritjes së treguesit gjeografik duhet të përmbajë:

a) emrin dhe adresën e pronarit të treguesit gjeografik;

b) numrin e kërkesës dhe numrin e regjistrimit të treguesit gjeografik;

c) datën e depozitimit, datën e mbarimit të mbrojtjes, datën e ripërtëritjes;

ç) përcaktimin e produktit për të cilin do të përdoret treguesi gjeografik;

d) përcaktimin e kufijve të lokalitetit gjeografik ku prodhohet ose përpunohet produkti.

2.4 DPPM-ja bën publikimin e ripërtëritjes në Buletinin e Pronësisë Industriale.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

KËRKESË PËR RIPËRTËRITJE TREGUESI GJEOGRAFIK

 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE Bulevardi "Gjergj FISHTA", Nr. 10 Kati i pestë, Tiranë, Shqipëri (AL) Email: mailinfo@dppm.gov.al Web Site: www.dppm.gov.al	<u>nyrësuar për Zyrën/te mos përdoret nga aplikanti</u> referenca: nr i prot:
---	--

1	TË DHËNA LIDHUR ME TREGUESIN GJEOGRAFIK NUMRI I KËRKESËS..... NUMRI I REGJISTRIMIT DATA E DEPOZITIMIT (nëse ripërtëritet për herë të parë) DATA E REGJISTRIMIT DATA E MBARIMIT TË AFATIT TË REGJISTRIMIT
-----------------	---

2	PRONARI I TREGUESIT GJEOGRAFIK (Ashtu si është në regjistrim) a) Emri: b) Adresa: (Kodi postar/Cytetu/Stateti) c) Adresa për korrespondence (nëse është e ndryshme nga me sipër) Telefon/Fax: E-mail: d) Statusi Ligjor.....
-----------------	--

3	PËRFAQËSUESI ose PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR (në rast se ka) Emri: Adresa: Telefon: Fax: E-mail: (nëse është ndryshe nga përfaqësuesi i autorizuar nga DPPM-ja) Kodi i Përfaqësuesit të Autorizuar:
-----------------	---

4 TREGUESI GJEOGRAFIK.....

KUFIJTË E LOKALITETIT GJEOGRAFIK (ku prodhohet, përpunohet produkti).....

5 LLOJI DHE MËNYRA E PAGESËS

Tarifa bazë për tregues gjeografik (..... lekë).....

Lloji i pagesës

dd/mm/rrrr

(Llogaria bankare në të cilën do të kryhet pagesa:
Dedës në thesarit për Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave „në qka Banka“)

6 PRODUKTI

(a) Shënoni me poshtë produktin për të cilin do të përdoret treguesi gjeografik:

7 NËNSHKRIMI I APLIKANTIT OSE PËRFAQËSUESIT TË TIJ – DATA

Emër/Mbiemër..... Data:..... (dd/mm/rrrr)

Nënskrimi:.....